



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit- Kancelarija Premijera-Office Of The Prime Minister
Sekretari i Përgjithshëm-Generalni Sekretar- Secretary General

Në mbështetje të Ligjit nr. 03/L-229 për Mbrojtën e Konkurrencës, përkatësisht nenit 25.4, të shpallur me Dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës me datën 25 shtator 2010, për të identifikuar dhe intervistuar kandidatëve për anëtar të Bordit të Komisionit të Konkurrencës, Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit shpall:

KONKURS

Për pozitën si vijon:

Katër (4) kandidatët për anëtarë të Bordit të Komisionit të Konkurrencës.

KUALIFIKIMI DHE PËRSHTATSHMËRIA PROFESIONALE

Një kandidat për t'u zgjedhur anëtarë i Bordit të Komisionit të Konkurrencës duhet të ketë kualifikime dhe përvojë pune sipas nenit 26 pika 1 të Ligjit nr. 03/L-229 për Mbrojtën e Konkurrencës.:

- Anëtari Bordit të Komisionit të Konkurrencës duhet të jetë shtetas i Republikës së Kosovës i cili ka kualifikimin superior në fushën e drejtësisë, ekonomisë apo drejtim ekuivalent dhe ka së paku shtatë vjet provojë pune në profesion.

KUSHTET

Kandidatët që konkurrojnë për anëtarë të Bordit të Komisionit të Konkurrencës duhet të plotësojnë edhe këto kushte të përgjithshme:

- Nuk ka qenë i dënuar dhe nuk është nën hetime nga një gjykatë kompetente;
- Nuk ka shkelur kodin etik apo standardet e sjelljes profesionale, përveç nëse një dënim i tillë është ndryshuar nga një gjykatë ose organ tjetër i ankesave;
- Nuk ka bërë përgënjeshtime materiale nën çfarëdo dëshmie nën betim;
- Nuk ka qenë në post menaxhues të ndonjë kompanie që ka falimentuar gjatë dhjetë (10) vjetëve të fundit.

INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT LIDHUR ME PROCEDURAT E KONKURIMIT

Kandidatët për anëtarë të Bordit të Komisionit të Konkurrencës duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- CV-në
- Letër motivimin
- Deklaratën nën betim (formular, i cili plotësohet në momentin e dorëzimit të dokumentacionit)
- Dokumentacionet e parapara në kushtet e punësimit (dëshmitë e kualifikimit profesional, përvojës së punës)
- Certifikatën (dëshminë) që dëshmon se nuk është nën hetime
- Shtetas i Kosovës (kopje të pasaportës ose të letërnjoftimit).

Aplikuesi për konkurrim duhet të përgatisë deklaratën nën betim, në të cilën deklaron se ai/ajo i përmbush kushtet e kualifikimit, pavarësisë dhe të përshtatshmërisë profesionale. Çdo përgënjeshttrim material, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca, ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipërpërmendur, do të rezultojë në diskualifikimin e menjëhershëm.

Dokumentacioni duhet të jetë në pliko (zarf) të mbyllur (të shkruhet emri dhe mbiemri si dhe emri i Komisionit të Konkurrencës në të cilën konkurron kandidati) dhe të dorëzohen në Sekretariati Koordinues i Qeverisë, kati i I -rë, zyra nr. 105 Ndërtesa e Qeverisë.

Dokumentacioni i dorëzuar nuk kthehet. Origjinalet mund të kërkohen gjatë intervistës.

Për informata shtesë mund të njoftoheni përmes telefonit 038/ 200 14 400.

Do të kontaktohen vetëm kandidatët e përzgjedhur.

Afati i konkursit është i hapur 15 ditë nga data e publikimit në shtypin ditor (prej datës 16 shtator 2013 deri më datën 30 shtator 2013).